



21.03.2022/Eu

**RAPORTI I PERFORMANCES
NEHEMIAH GATEWAY ALBANIA
JANAR – DHJETOR 2021**

PËRMBAJTJA

I.	Objektivat dhe aktivitetet	3
I.1.	Qëllimi i themelimit.....	3
I.2.	Aktivitetet kryesore të ndërmarra në lidhje me qëllimet	4
I.2.1.	Ndihma sociale dhe mjekësore	4
I.2.2.	Edukimi.....	4
I.2.3.	Fuqizimi i Projekteve	4
I.2.4.	Implementimi i vlerave themelore.....	5
II.	Arrijet dhe performanca.....	5
II.1.	Projektet sociale	5
II.1.1.	Mensat sociale dhe pakot ushqimore	5
II.1.2.	Ndihma humanitare	5
II.1.3.	Infermieri	6
II.1.4.	Fizioterapia.....	6
II.1.5.	Qendra e shërbimit logopedik.....	6
II.1.6.	Kampet verore.....	6
II.2.	Programet e edukimit.....	7
II.2.1.	Shkolla Nehemia	7
II.2.2.	Shkolla Amaro Tan.....	7
II.2.3.	Siguria në rrugë.....	8
II.2.4.	Shkolla e Lartë Nehemiah Gateway	8
II.2.5.	Kurse të gjuhëve të huaja.....	9
II.3.	Fuqizimi i projekteve	9
II.4.	Implementimi i vlerave themelore	9
III.	Raportimi financiar	11
III.1.	Arrijet në gjetjen e burimeve të financimit.....	11
III.2.	Mirëpërdorimi i burimeve	13
IV.	Struktura, drejtimi dhe raportimi	14
IV.1.	Të dhëna identifikuuese	14
IV.2.	Struktura organizative	15
IV.2.1.	Bordit Mbikëqyrës	15
IV.2.2.	Organizimi i drejtimit	18
V.	Planet për të ardhmen.....	19

Bazuar në Udhëzuesin për Raportin e Performancës së Organizatave Jofitimprurëse (OJF) në Shqipëri i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe në zbatim të nenit 22 (3) të Ligjit 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", Fondacioni Nehemiah Gateway Albania paraqet raportin e performancës si më poshtë:

I. Objektivat dhe aktivitetet

Fondacioni Nehemiah Gateway Albania është themeluar në datën 20.02.1992 dhe regjistruar si fillim pranë Ministrisë së kulturës, Rinisë dhe Sporteve me Nr. 73 date 20.02.1992 me emrin: Shoqata "Nehemia – Shërbesë e Ndihmës Kristiane dhe me pas në datën 17.08.1992 u regjistra pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe në 21.07.1995 është regjistruar si Fondacioni Nehemia për të përbushur qëllimet dhe aktivitetet si më poshtë:

I.1. Qëllimi i themelimit

Tek Statuti i Fondacionit Nehemiah Gateway Albania neni 1 është përcaktuar formimi dhe qëllimi si më poshtë:

- 1.1. Fondacioni "Nehemiah Gateway Albania" me qendër në Buçimas, është krijuar në përputhje me Aktin e Themelimit të Fondacionit, datë 21.07.1995, i ndryshuar, si dhe në përputhje me nenet 54 deri 63 të ligjit Nr.7850 datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" dhe Ligjet Nr. 8788 datë 7.5.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse" i ndryshuar.
- 1.2. Qëllimi kryesor i Fondacionit është organizimi dhe zhvillimi i një pune të gjerë në drejtim të forcimit të besimit tek Perëndia, si e vetmja rrugë për pastrimin shpirtëror të njerëzve, forcimi i edukatës dhe vlerave sociale dhe njohjen e respektimit e personalitetit njerëzor, organizimi i një arsimi privat laik dhe fetar, puna për nxitjen e frysës ndërkulturore dhe ndërfetare si dhe të mirëkuptimit midis popujve, sigurimi i një ndihme materiale dhe financiare, sigurimi i një ndihme materiale dhe financiare për arsimin, kulturën, shëndetësinë dhe punët e tjera komunale e kombinuar kjo me sigurimin dhe organizimin e bashkësive të krishtera.
- 1.3. Pë arritjen e këtyre qëllimeve, Fondacioni mbani lidhje me organizata homologe, institucione dhe organizata ndërkombëtare si dhe individë të vecantë, të cilët me ndihmesën e tyre mbështesin veprimtarinë e Fondacionit, gjithmonë duke ruajtur Fondacioni pavarsinë e tij, duke zhvilluar një aktivitet të gjerë në fusha të ndryshme të veprimtarisnjë aktivitet të gjerë në fusha të ndryshme të veprimtarisë dhe që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së tij, por gjithnjë pa qëllim fitimi, dhe në rritje dhe administrimin e fondeve dhe aseteve të Fondacionit.
- 1.4. Fondacioni e ushtron aktivitetin e tij në bazë dhe në zbatim të Konventës së Lozanës të vitit 1974.

Dy qëllime të rëndësishme të Fondacionit janë:

1. Qëndrueshmëria

Mbi të gjitha, ne duam t'iu ofrojmë njerëzve me nevoja të veçanta sociale, mundësinë për të ndërtuar një ekzistencë të qëndrueshme. Më pas, ata mund të krijojnë, ose të mbështesin një komunitet të qëndrueshëm të mbështetur në norma dhe vlera të sigurta.

2. Të ndihmojmë njerëzit të ndihmojnë vetveten

Duke kriuar dhe mbështetur projektet që kanë për qëllim "Të ndihmojmë njerëzit për të ndihmuar vetveten" në vende të caktuara, ne duam të kontribuojmë në krijimin e kushteve të përshtatshme, duke u dhënë njerëzve, struktura të besueshme edhe brenda vendit të tyre.

I.2. Aktivitetet kryesore të ndërmarrës në lidhje me qëllimet

Për të përbushur qëllimet dhe misionin, Fondacioni Nehemiah Gateway Albania e mbështet punën në katër shtylla kryesore të cilat janë si më poshtë:

I.2.1. Ndihma sociale dhe mjekësore

Ndihma fizike dhe psikologjike, si dhe mbështetja sociale janë të nevojshme në mënyrë që të aftësojmë njerëzit të kujdesen për vetveten.

I.2.2. Edukimi

Edukimi është burim për një ndihmë të qëndrueshme dhe të vetëmjaftueshme, si dhe një themel i rëndësishëm për ruajtjen e dinjitetit njerëzor.

I.2.3. Fuqizimi i Projekteve

Këshillimet dhe mbështetja profesionale mundësojnë që iniciativat të marrin jetë dhe të kthehen në organizata të suksesshme, nëse në themel kanë parimin e qëndrueshmërisë. Ne trajnojmë dhe këshillojmë drejtuesit dhe sipërmarrësit e ardhshëm se si mund të ndihmojnë të tjerët, përtëj metodave formale të edukimit në shkollë dhe universitet.

I.2.4. Implementimi i vlerave themelore

Ne besojmë se vlerat janë një themel i rëndësishëm që një individ apo shoqëri të mund të ndihmojë vetveten në mënyrë të qëndrueshme.

II. Arritjet dhe performanca

Për vitin 2021 Fondacioni Nehemiah Gateway Albania, ka përbushur qëllimet e saj duke pasur arritjet në katër shtyllat kryesore në të cilat ka organizuar punën si më poshtë:

II.1. Projektet sociale

Nëpërmjet projekteve sociale Fondacioni Nehemiah Gateway ka përbushur qëllimet duke ju ofruar shërbime njerëzve në nevojë. Në këtë mënyrë ju ka dhënë atyre mundësinë të kenë një jetë të qëndrueshme dhe të pavaruar. Për vitin 2021 projektet sociale kanë kushtuar 19.932.243 lekë nëpërmjet të cilave Fondacioni ka pasur arritjet si më poshtë :

II.1.1. Mensat sociale dhe pakot ushqimore

Ky projekt është krijuar 25 vjet më parë si një shërbim ditor për njerëzit, të cilët nuk kishin aspak ose shumë pak të ardhura. Aktualisht, Fondacioni ka mensa sociale në Pogradec (Amaro Tan) dhe Gjirokastër. Këto mensa u shërbijnë çdo ditë një vakt të nrohtë jo vetëm fëmijëve që janë pjesë e programit arsimor në këto qendra, por edhe njerëzve në nevojë të cilët nuk kanë mundësi që të ushqejnë veten, janë të pastrehë, të moshuar të cilet nuk kanë familjarë që të kujdesen si dhe femijët Romë dhe familjet e tyre.

Çdo vit përgatiten paketa ushqimore dhe shpërndahen nëpër familje, të cilat ndodhen në zona të thella të rrethit të Pogradecit. Pakot përbajnjë ushqime bazë si (oriz, makarona, sheqer, vaj etj.) dhe në këtë mënyrë plotësohen nevojat afatshkurtra të këtyre familjeve. Për vitin 2021 Fondacioni ka siguruar nëpërmjet projektit Amaro Tan në Pogradec 29.237 vakte ushqimore dhe 9.364 vakte nëpërmjet projektit në Gjirokastër. Fondacioni përveç vakteve të nrohta ka krijuar edhe ambiente ku njerëzit të mblidhen sëbashku, të kalojnë kohe miqësie me njëri-tjetrin dhe për ndërveprim social që shumë prej tyre nuk e kanë.

II.1.2. Ndihma humanitare

Gjithashtu Fondacioni Nehemiah Gateway Albania ka ofruar edhe ndihma materiale për njerëzit në nevojë. Ndihmat materiale kanë qenë të nevojshme si ndihmë e parë për njerëzit në kohë krize.

Në vitin 2021 janë shpërndarë 397 pako ushqimore nëpërmjet projektit Amaro Tan në Pogradec, 691 nëpërmjet projektit social në Bucimas dhe 156 nëpërmjet projektit në Gjirokastër. Ndihamat materiale kanë qenë të ndryshme si: pako ushqimore 12 kg secila, rroba & veshmbathje, ribursime biletash udhetimi, rimbursime të recetave mjekësore, materiale mjekësore, dru për ngrohje, materiale për ndërtim, etj.

Fondacioni Nehemiah Gateway Albania ofron disa shërbime për përmirësimi social dhe mjekësor si: fizioterapi, infermieria, qendra e shërbimit logopedik.

II.1.3. Infermieria

Një shërbim mjekësor cilësor është i vështirë për tu mundësuar, në të shumtën e rasteve. Fondacioni ofron një sërë shërbimesh infermierore personave në nevojë, kur atyre vetë u mungon mundësia për të gjetur një shërbim cilësor. Përveç shërbimit falas për klientët social në qendrën në Buçimas, gjithashtu mundëson që t'i ofrohen të njëjtat shërbime, në shtëpitë e tyre, edhe atyre që e kanë të pamundur të vijnë në infermierinë e ndodhur në kampus. Për 2021 janë bërë 297 depistime, 471mjekime ,104 dushe e personave në nevojë. Gjithashtu janë bërë 21 këshillime sociale dhe 16 trajnime të ndihmës së parë për 130 persona.

II.1.4. Fizioterapia

Gjithashtu fizioterapistë të trajnuar ndihmojnë persona me dëmtime fizike që të mund të rikuperohen sa më shpejt dhe të jetojnë një jetë më cilësore. Shpesh ndodh që këto dëmtime vështirësojnë ardhjen e tyre në qendër dhe për këtë arsyë Fondacioni mundëson shërbime fizioterapie edhe në shtëpitë e tyre.

Fondacioni ka përbushur qëllimet për të ndihmuar njerëzit duke ofruar 2.176 seanca fizioterapi dhe shërbimi mjekësor, 92 ushtrime terapeutike, dhe 430 vizita mjekësore për vitin 2021.

II.1.5. Qendra e shërbimit logopedik

Fondacioni duke parë nevojnë e madhe për shërbime logopedie, si dhe për Sindromën Down dhe autizmin, ofron terapi të të folurit dhe edukimit për persona me aftësi ndryshe, për 27 persona irregullisht në qendrën e shërbimit logopedik. Gjithashtu, çdo vit organizohen kampe ditore, në të cilat iu shërbehet fëmijëve me aftësi ndryshe nga punonjëset tona sociale dhe ndihmohen fëmijët të komunikojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre sociale. Për vitin 2021 janë ofruar 355 seanca logopedie dhe 517 pedagogji zhvillimi.

II.1.6. Kampet verore

Gjatë kohës që viti shkollor ka mbaruar, shumë fëmijë detyrohen ta kalojnë pjesën më të madhe të kohës në rrugë ose në shtepi, duke u vendosur përballë me situata të vështira familjare. Çdo vit Fondacioni organizon kampe verore për fëmijët në të cilat kanë mundësi të luajnë, të krijojnë miqësi të reja, të jenë krijues në mënyrat e tyre dhe të rrisin aftësitë

e tyre sociale. Me një shumëlojshmëri sportesh, lojërash, aktivitetesh edukative etj., fëmijët kanë një mundësi ndryshe si të shpenzojnë stinën e verës. Në këto kampe ofrohen po ashtu shumë aktivitete sportive dhe fëmijët hanë së bashku një drekë të ngrrohtë. Ato organizohen për fëmijët Romë dhe të varfër në rajonin e Pogradecit dhe Gjirokastës si dhe për fëmijët e shkollave të qytetit Pogradec.

Për vitin 2021, shkolla Amaro Tan organizoi 2 kamp veror me 106 fëmijë në nevojë. Në Bucimas përfëmijët me aftësi të kufizuara (PAK) janë organizuar edhe kampe 2 javore për 20 fëmijë nën kujdesin e punonjëseve sociale dhe me kushte të distancimit dhe higjenës së shtuar, diktuar nga situata. Gjithashtu, janë 14 aktivitetet sociale argëtuese me fëmijët dhe gratë si edhe takimet e qelizave.

II.2. Programet e edukimit

Përgjatë viteve duke ju shërbyer njerëzve në nevojë më udhqiime dhe ndihma materiale Fondacioni Nehemiah Gateway pa nevojnë e një ndihme më të madhe dhe afatgjatë që t'i ndihmojë njerëzit të bëhen të qëndrueshëm dhe të pavarur përfëmijët e tyre në dinjitet. Në këtë kontekst edukimi u pa si një nga mënyrat përfjuar njerëzve me shumë sesa përgjigje emergjente përfëmijët. Qëllimi i edukimit është që të formojë personalitetin e nxënësve dhe studentëve dhe t'i ndihmojë ata të zbulojnë potencialin e tyre, duke i frymëzuar që të jenë përgjegjës përfëmijët e tyre, të familjeve të tyre dhe shoqërisë, në të cilën ata jetojnë.

II.2.1. Shkolla Nehemia

Fondacioni, nëpërmjet Shkollës "Nehemia", ofron arsimim me cilësi të lartë dhe të bazuar në vlera përfëmijët në Pogradec. Përmirësimet e vazhdueshme në Shqipëri i kanë dhënë mundësinë Fondacionit Nehemiah Gateway Albania të kontribuojë në mënyrë pozitive duke edukuar përfëmijët. Falë stafit, bashkëpunimit me prindërit dhe donatorëve tanë, edhe gjatë 2021 çdo ditë në Shkollën Nehemia është investuar në 470 fëmijë nga kopshti në shkollën e mesme duke ju dhënë atyre më të mirën, duke ju treguar se vlerat etike janë bazat përfëmijët e tyre. Duke i fuqizuar përfëmijët e talentuar, dhe njëkohësisht ndihmojnë ata që kanë nevojë. Në këtë vit janë mbështetur financiarisht përfjuar 26 nxënës rrith 3.626.249 leke/vit shkollor. Në total shpenzimet e Shkollës "Nehemia" përfjuar 2021 janë 79.806.647 lekë, të cilat mbulohen 76% nga tarifa shkollore dhe 24% nga donacionet.

II.2.2. Shkolla Amaro Tan

Duke parë realitetin në Shqipëri në lidhje me vështirësitë që kishin fëmijët me probleme sociale, të varfër apo që vinin nga komunitetet Rome dhe Egjiptjane përfjuar edukuar, Fondacioni Nehemiah Gateway Albania ofron kopshtin dhe shkollën Amaro Tan. Një mjeshtës, siç e sugjeron edhe emri "Amaro Tan" në gjuhën Rome- "vendi ynë", përfjuar dhënë këtyre fëmijëve një mundësi përfëmijët e marrë një edukim të mirë dhe përfëmijët e ardhme më të mirë. Amaro Tan ofron programe në edukim dhe të kujdesit social, dhe gjithashtu një vakt të ngrrohtë falas. Gjithashtu ofron kurse profesionale

për t'ju dhënë një aftësi profesionale në rrobaqepësi, gatim, gjuhë të huaja, zdrukhtari. Fëmijët kanë mundësi të mësojnë vizatim, dramë dhe muzikë për të pasuruar jetën e tyre. Për vitin 2021 është investuar në 136 nxënës të regjistruar në Shkollën Amaro Tan me kosto 33.753.112 lekë të cilat mbulohen 100% nga donacionet. 3 prej nxënësve të Shkollës Amro Tan vazhdojnë shkollën e mesme pranë Shkollës "Nehemia", 1 nxënës u regjistrua në shkollën e mesme profesionale Enver Qiraxhi, 1 nxënës u regjistrua në shkollën e mesme të përgjithshme Gjergj Pekmezi.

II.2.3. Siguria në rrugë

Fondacioni Nehemiah Gateway Albania ka dhënë një kontribut për shoqërinë për një problem të madh siç janë dhe aksidentet në rrugë. Për këtë arsyе në bashkëpunim me speicalistë të polisës Bavareze , Nehemiah Gateway Albania hartoit një projekt përfëmijët e klasave të 4, fillore të shkollave publike dhe private të zonës, që të mësojnë rregullat e sigurisë rrugore, pra, si të ecin të sigurtë si këmbësorë dhe si të drejtøjnë bicikletat në mënyrë të përgjegjëshme për të mbrojtur të tjerët. Në gusht të 2014 një pjesë e kampusit te Fondacionit Nehemiah Gateway Albania u transformua në një pistë të vogël trafiku për praktikim në terren, e cila që prej asaj kohe është përdorur për trajnimet e sipërpërmendura. Gjatë javës nxënësit nga shkollat publike të Pogradecit vizitojnë kampusin për të bërë trajnimin me bicikletat dhe makina Dyno. Edhe gjatë vitit 2021 patëm mundësinë të ofrojmë këto trajnime dhe janë trajnuar 3 shkolla publike (Gjok Shqiptare, Koli Gusho dhe Koli Koci) si dhe 2 shkolla private (Shkolla Nehemia dhe Amaro Tan); në total 182 nxënës.

II.2.4. Shkolla e Lartë Nehemiah Gateway

Si një organizatë humanitare ndërkombëtare misioni ynë është të fuqizojmë jo vetëm njerëzit në Shqipëri por edhe ndërkombëtarisht. Për këtë arsyë Fondacioni themeloi Shkollën e Lartë Nehemiah Gateway si një institucion i arsimit të lartë i cili iu jep mundësinë e ndjekjes së studimeve të larta, jo vetëm studentëve vëndas por edhe studentëve nga Europa, Afrika, Amerika Latine, Kuba etj. Studentët kanë mundësi të ndjekin studimet e ciklit të parë Bachelor në Biznes një sistem dual bazuar në modelin Gjerman dhe gjithashtu studimet e ciklit të dytë Master i Shkencave në Lidership. Në vitin 2021 kanë ndjekur studimet bachelor 48 studentë, studimet master 24 studentë dhe në total janë 108 studentë të diplomuar. Pjesë e programit bachelor kanë qenë dhe 7 studentë ndërkombëtarë. Shkolla e Lartë Nehemiah Gateway ka fituar 3 akreditime:

- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në Shqipëri, përmes vendimit nr. 63 datë 21 - 22 shtator 2017, i ka dhënë Shkollës së Lartë Nehemiah Gateway akreditimin institucional për një periudhë prej pesë vitesh akademike deri më 30 shtator 2022 (www.ascal.al). Programi Bachelor në "Ekonomi dhe Biznes" është akredituar nga Agjensia e Akreditimit Publik Shqiptar (APAAL), paraardhësi ligjor i ASCAL, përmes vendimit nr. 97 datë 20.10.2017 për një periudhë prej gjashtë viteve akademike deri më 30.09.2023, ndërsa programi Master i Shkencave "Lidership dhe Vlerësimi në Arsim" është i akredituar përmes vendimit nr.98, datë 20.10.2017 për një periudhë prej katër viteve akademike deri më 30.09. 2021.

- Në nëntor 2012, Programi i studimit Bachelor në "Ekonomi & Biznes" u akreditua nga FIBAA, agjensia gjermane e akreditimit dhe anëtare e ENQA, dhe u akreditua në 26 shkurt 2016 për shtatë vjet të tjerë (deri në fund të semestrit veror 2023). Programi i Masterit Shkencor në "Lidership dhe Vlerësimi në Arsim" u akreditua në Nënëtor 2015.
- Shkolla e Lartë Nehemiah Gateway është anëtare e Shoqatës Transnacionale të Kolegjeve dhe Shkollave të Krishtera (TRACS), duke marrë statusin e akredituar si një institucion i Kategorisë III nga Komisioni i Akreditimit TRACS më 19 Prill 2016. Ky status është i vlefshëm deri më prill 2022. TRACS njihet nga Departamenti i Arsimit i Shteteve të Bashkuara (USDOE), Rrjeti Ndërkombëtar për Agjencitë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (INQAAHE) si dhe Këshilli për Akreditimin e Arsimit të Lartë (CHEA)(www.chea.org).

Shkolla e Lartë Nehemiah Gateway për 2021 ka kushtuar 65.960.151 lekë ku nga të cilat 9% mbulohen nga tarifat e studimit dhe 91% nga donacionet.

II.2.5. Kurse të gjuhëve të huaja

Në Shqipëri të rintjtë hasin vështirësi të gjejnë punë sepse shumë prej tyre nuk kanë edukimin dhe orinetimin e duhur. Për këtë arsyе Fondacioni, për t'ju dhënë mundësi më të mira dhe për të mbështetur këtë grup organizon kurse intensive të gjuhës Gjermane në bashkëpunim me Beck International Recruitment, duke ju dhënë mundësinë që të marrin arsimim praktik në Gjermani. Në këtë mënyrë ata krijojnë pavarësi dhe qëndrushmëri për jetët e tyre dhe kanë një të ardhme më të mirë. Në këto kurse kanë marrë pjesë 55 studentë. 5 studentë kanë marrë nivelin B2.

II.3. Fuqizimi i projekteve

Nëpërmjet këtij drejtimi strategjik, ju jepet mundësia njerëzve të krijojnë biznese dhe mbështesin familjet e tyre duke zhvilluar komunitetin e tyre. Fondacioni bashkëpunon me Nehemiah Gateway Team për të arritur këtë objektiv dhe në Shqipëri ofron kualifikime për të rind përmes kurseve, moduleve të hapura në Shkollën e Lartë Nehemiah Gateway dhe praktikave profesionale.

Gjatë vitit 2021 janë trajnuar në zdrukhtari dhe punim me letër 19 nxënës dhe 34 nxënës në rrobaqepsi me një kosto prej 1.690.732 lekë.

II.4. Implementimi i vlerave themelore

Fondacioni Nehemiah Gateway Albania është krijuar mbi vlera të Krishtera. Për të transmetuar këto vlera themelore ofron programin Royal Rangers ku fëmijët e të gjitha moshave marrin pjesë në lojra dhe aktivitete në grupe. Në këto aktivitete ata mësojnë në praktikë si të mbrojnë natyrën, si të mbështesin dhe pranojnë njëri-tjetrin, si të punojnë në


grup, t'i kuptojnë dhe ndihmojnë njerëzit në nevojë. Gjithashtu në këto aktivitete ata mësojnë dhe vlerat e krishtera të cilat i ndihmojnë ata të kuptojnë që pa këto vlera nuk mund të ndërtosh një skuadër të fortë që mbështet njëri-tjetrin dhe ndihmon ata që kanë nevojë. Kjo është edhe arsyja që Fondacioni në çdo gjë që bën praktikon vlerat e Krishtera. Gjatë vitit 2021 është zhvilluar një kamp 2 javor me 80 fëmijë për shkak të kushteve të vështira të krijuara nga Covid-19 si dhe një kamp me çadra në Durrës me 10 fëmijë. Janë organizuar 3 shëtitje në mal ku kanë marrë pjesë 60 fëmijë, 1 trajnim bashkëpunatorësh me 15 pjesëmarrës, si dhe çdo javë organizohen 8 takime sipas kalasave dhe një trajnim të bashkëpunatorëve (150 pjesëmarrës në javë). Gjithashtu është botuar libri i parë i informatorëve. Ky projekt për vitin 2021 ka pasur një kosto prej 1.672.628 lekë.

Pjesë e disa aktiviteteve të përmendura më lart, kanë qenë dhe vullnetarët ku kanë dhënë kontributin e tyre në programe të ndryshme të Fondacionit. Për 2021 kanë kontribuar 4 vullnetarë nga Gjermania dhe 1 nga USA. Këta vullnetarë kanë shërbyer për periudha të ndryshme në organizatë nga 6 muaj deri në një vit ku 3 vullnetarë kanë shërbyer tek projekti i Shkollës Amaro Tan, puna sociale, etj. Gjithashtu 2 praktikantë nga Ludwig Maximilian University of Munich kanë ndihmuar tek Shkolla "Nehemia" për gjuhën gjermane. Kontributi i vullnetarëve ka qene shumë i rëndësishëm si nga ana profesionale dhe praktike në fushat e përmendura më lart.

Natyra e shpenzimeve sipas projekteve të përshkruar me lartë, vlera e të cilave për 2021 ka qene 222.731.023 lekë është shpërndarë si tek diagrami Nr.1 si më poshtë:

Diagram 1

Natyra e shpenzimeve sipas projekteve



Fondacioni Nehemiah Gateway Albania zhvillon projekte sociale dhe arsimore duke fuqizuar kryesisht të rinjtë përmes formimit të aftësive akademike dhe profesionale si dhe përmes edukimit të vlerave me qëllim plotësimin e misionit të vet me në fokus njeriun. Shpenzimet me përqindje më të larta konkretisht me 65% janë për projektet e edukimit si: Shkolla "Nehemia" ku si shkollë private shpenzimet mbulohen 76% nga tarifa shkollore dhe 24% nga donacionet, Shkolla Amaro Tan shpenzimet e të cilës mbulohen 100% nga donacionet dhe Shkollën e Lartë Nehemiah Gateway shpenzimet e të cilës mbulohen 9% nga tarifa e studimit dhe 91% nga donacionet. Një pjesë të konsiderueshme me 24% janë dhe shpenzimet të përgjithshme që mbështetin këto projekte si departamentet e administratës të cilat mbulohen 100% nga donacionet si dhe qendra të tjera si marketingu, IT, menaxhimi i objekteve etj. Projekte të cilat kryejnë aktivitete ekonomike ku të ardhurat përdoren për të mbështetur projektet dhe qëllimin e Fondacionit, shpenzimet e te cilave mbulohen 14% nga të ardhura nga shërbimet e jashtme, 60% transfera të brendshme dhe 26% nga donacionet. Gjithashtu projekti social me 9% si një projekt i rendësishëm në shërbim të njerëzve në nevojë dhe pjesa tjetër prej 2% është për implementimin e vlerave dhe fuqizimin e projekteve. Të gjitha donacionet apo të ardhurat shkojnë për të mbuluar shpenzimet e këtyre projekteve dhe plotësimin e qëllimit dhe objektivave të Fondacionit Nehemiah Gateway Albania.

III. Raportimi financiar

III.1. Arritjet në gjetjen e burimeve të financimit

Fondacioni Nehemiah Gateway Albania mbështetet kryesisht nga donacionet. Nehemiah Gateway Albania është pjesë e Nehemiah Gateway Team (NG Team). Nehemiah Gateway Team përbehet nga : NGS gGmbH, NG US, NG CH,

NG AL. NG Team ka zyra në Gjermani, Nuremberg dhe Berlin dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Colorado. Këto zyra koordionojnë shumëlojshmérinë e projekteve të gjithë Nehemiah Gateway Team në nivel ndërkombëtar dhe njëkohësisht janë pika kontakti për donatorët dhe mbështetësit. Po ashtu, këto zyra krijojnë dhe mirëmbajajnë rrjete që mbështesin punën e NG Team duke përfshirë njerz nga fushat e politikës, biznesi etj. në vende ku NG Team operon. NGS gGmbH, e cila është një kompani jo-fitimprurëse me përgjegjësi të limituar, e cila ka investuar financiarisht në të gjithë punën e NG Team. Kjo përfshin edhe administrimin e aseteve dhe operimin e bizneseve trajnuese si "Lindenhof Resort & Events GmbH" dhe "MoHab GmbH". Duke qenë se shpenzimet administrative të Nehemiah Gateway Albania mbulohen të gjitha nga NGS gGmbH, kjo mundëson që të gjitha donacionet financiare të ngritura për projektet tona sociale dhe edukative të kalojnë plotësisht për qëllimin e dhuruar duke përdorur direkt në projektet tona pa kosto administrative të shtuar.


Donacione janë të ndryshme si:

- Donacione financiare (për vetëm njëherë si dhe donacione të rregullta)
- Donacione me të mira materiale
- Punë vullnetare nga ekspertë të fushave të ndryshme profesionale

Gjithashtu Fondacioni ka mundësi të krijojë të ardhura nga shërbimet e ndryshme. Për shembull tarifat shkollore që sigurohen nga prindërit e nxënësve dhe studentët, të cilët kanë mundësi t'i përballojnë ato. Nxënësit dhe studentët me të ardhura të ulëta janë të përjashtuar plotësisht ose pjesërisht nga këto tarifa dhe mbështeten nga programe të veçanta. Për vitin 2021 natyra e burimeve financiare të arritura nga Fondacioni Nehemiah Gateway Albania është si më poshtë:

Diagram 2

Natyra e burimeve financiare



Burimi finansiar më i madh i Fondacionit Nehemiah Gateway Albania për vitin 2021 është nga donacionet 63.4% (55.4%, donacionet e rregullta, 0.6% donacionet për vetëm njëherë dhe 1.3% donacione me të mira materiale, 6.1% transferta të brendshme midis projekteve për mbulimin e kostove dhe shërbimeve të ofruara dhe këto janë mbuluar gjithashtu nga donacionet e rregullta). Ndërsa të ardhurat nga shërbimet ndaj të tretëve janë 36.6%. (36.1% të ardhurat nga shërbimet dhe 0.5% i të ardhurave të tjera të cilat janë rimbursime dhe fitim nga kursi i këmbimit).

III.2. Mirëpërdorimi i burimeve

Transparenca është e rëndësishme për Fondacionin Nehemiah Gateway. Mbështetësit na besojnë duke dhuruar, investuar energji dhe njohuritë e tyre. Ata ndajnë të njëjtin pasionin me ne për të ndihmuar njerëzit dhe për t'ju dhënë një të ardhme me të mirë. Ky besim na motivon ne si Fondacion për të trajtuar financat në mënyrë profesionale, të punojmë në mënyrë efikase dhe të përkushtuar duke respektuar rregullat dhe kufijtë ligjorë. Për këtë gjë Fondacioni ka ndërtuar një manual të brendshëm, duke përbledhur standarde më të mira të fushës, udhëzime, rregulla, politika, procedura, etj. që të gjitha projektet dhe organizatat brenda NG Team t'i respektojnë dhe t'i përdorin në mënyrë të përgjegjshme. Në këtë mënyrë Fondacioni siguron që çdo burim i të ardhuarve të menaxhohet në mënyrën e duhur dhe të shkojë për projektet të cilat është dhuruar. Donatorët informohen rreth donacioneve që kanë bërë duke marrë të dhëna për menaxhimin e shumave që kanë dhuruar dhe fotografi. Për Fondacionin transparenca dhe komunikimi me donatorët është shumë i rëndësishëm.

Stafi i Nehemiah Gateway Albania është i përkushtuar të trajtojë me përgjegjësi mjetet dhe fondet e organizatës. Planifikimi i buxhetit kalon në disa fazë të vendimmarrjes dhe miratohet nga Bordi Mbikëqyrës. Për përgatitjen deri në miratimin e buxhetit ndiqen rregulloret dhe procedurat e përcaktuara në manual. Çdo drejtues projekti është përgjegjës

për menaxhimin dhe kontrollin e buxhetit dhe kahasimit mëjor me aktualin. Për çdo projekt pagesat bëhen nga një bashkëpunëtor i autorizuar për çështje bankare dhe i nënshtrohen kontrollit të rregullt. Për regjistrimet e të ardhurave, shpenzimeve, aktivet, detyrimet, etj. Fondacioni përdor programin kompjuterik QuickBooks, ku për çdo veprim plotësohen dhe regjistrohen detaje në mënyrë që çdo projekt të monitorojë shpenzimet dhe të ardhurat dhe gjithashtu për çdo donator shuma e dhuruar për një qëllim të caktuar të reflektohet në pasqyrat financiare. Në këtë mënyrë dhe raportet financiare janë më të qarta dhe të ndara sipas çdo projekti. Të gjitha financat e siguruara nga donatorët apo dhe shërbimet kanë përbushur qëllimet e Fondacionit duke kontribuar në shoqërinë shqiptare në zonat e Pogradecit dhe Gjirokastës duke mbështetur njerëzit në nevojë, duke ofruar shërbime sociale dhe mjekësore, duke ofruar edukim cilësor përfmijët si dhe duke ofruar kurse dhe trajnime të ndryshme. Të gjitha këto shërbjejnë për të ndihmuar dhe fuqizuar njerëzit që në mënyrë të qëndrueshme të formojnë dhe përcaktojnë jetët e tyre me dinjitet dhe pavarësi. Të gjitha këto shërbime janë të përkthyera në vlera monetare në pasqyrat financiare të detajuara për çdo projekt.

Për më tepër Nehemiah Gateway Albania përveç audititimit të jashtëm të kërkuar me ligj organizon çdo vit auditimin e brendshëm, duke caktuar kontabilistë të certifikuar publik (CPA) nga USA dhe ekspertë kontabiliteti nga Gjermania për të siguruar respektimin dhe ndjekjen e procedurave si dhe për të pasur një pasqyrim sa me transparent të burimeve financiare.

Në aneks do të gjeni më shumë informacion ne lidhje me auditimet dhe pasqyrat financiare.

IV. Struktura, drejtimi dhe raportimi

IV.1. Të dhëna identifikuuese

Fondacioni Nehemiah Gateway Albania është themeluar në datën 21.07.1995 si fondacion joftimprurëse.

Fondacioni është regjistruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec me Nr.Regj. 4569 dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Nr. Regj. 5/1 me NIPT J64103684E. Kryetari i Bordit Mbikëqyrës është: Arnold Geiger dhe Drejtues Ekzekutiv: Herolinda Shkullaku

Adresa e fondacionit është: 7304 Buçimas, Shqipëri. Selia dhe zyrat qendrore të Fondacionit janë në Njësinë Vendore Administrative Buçimas, bashkia Pogradec. Fondacioni ka degë në Pogradec të regjistruar me adresë dytësore: Lagija nr.4 Rruga Unazë, Pogradec me NIPT/SSN J64103684E dhe Gjirokastë të regjistruar me adresë dytësore Lagija Dunavat i I-rë, Rruga "Bule Naipi", 6002, Shtëpi Banimi në Zonën Kadastrale nr.8542, Nr.Pasurie 22/36, Qyteti Gjirokastër, Rrethi Gjirokastër me NIPT/SSN J64103684E.

IV.2. Struktura organizative

Organet drejtuese të Fondacionit janë Bordi Mbikëqyrës dhe Drejtori Ekzekutiv.

IV.2.1. Bordit Mbikëqyrës

Më poshtë do të gjeni informacion në lidhje me bordin mbikëqyrës:

Krytar i Bordit:

- Arnold Geiger – Themelues i NG Team

Lindur në vitin 1960 në Bayreuth, Gjermani. Z. Geiger dhe gruaja e tij zj. Esther kanë pesë fëmijë. Pasi mbaroi studimet për administratën publike, ai ushtroi funksione të ndryshme brenda policisë federale gjermane për nëntë vjet. Pas disa transporteve të mallrave të ndihmës dhe misioneve humanitare në vende të ndryshme duke përfshirë Sudanin, Eritrea, Malawi, Etiopinë, Rusinë, Rumaninë, Turqinë dhe Iranin, ai bashkë me familjen e tij vendosën të transferohen në Pogradec, në Shqipëri pas hapjes së kufijve në 1991 që të investonin në mënyrë aktive dhe të qëndrueshme në zhvillimin afatgjatë të asaj shoqërie. Ai krijoi një mori projektesh dhe shërbimesh të të gjitha llojeve: ndihma emergjente, mbështetje shpirtërore përmes kishave, ndihma mjekësore dhe sociale, si dhe institucionale arsimore që fillojnë nga kopshti deri në universitet. Z. Geiger është anëtar i themelues i organizatave të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Në Gjermani ai është dekoruar me Kryqin Federal të Meritës (Bundesverdienstkreuz) për angazhimin e tij të shumëanshëm në punën humanitare jashtë Gjermanisë (2008). Në 1998 është shpallur "Qytetar Nderi i Pogradecit". Me rastin e 25-vjetorit të Nehemiah Gateway në Shqipëri ai u dekorua me dokoratën e lartë "Nënë Tereza", duke nderuar arritjet e tij të jashtëzakonshme për vendin tonë

Anëtarët e Bordit:

- Helmut Hauser- Arkitekt

Lindur në 1950 në Egenhausen / Northern Black Forest, Gjermani. Pas përfundimit të studimeve të tij në arkitekturë në Universitetin e Shtutgartit, Helmut Hauser filloi karrierën e tij në 1976 duke punuar për Heuser + Dorner + Partner në Nagold. Si arkitekt dhe partner i ri, ai punoi për projekte të ndryshme të mëdha, kryesisht në fushën e shërbimeve sociale. Në 1984, ai themeloi zyrën e tij të arkitekturës hauserpartner në Egenhausen dhe në 2014 shtoi një zyrë tjeter në Berlin. Stafi i tij prej 22 bashkëpunëtorësh zbatojnë projekte arkitekture dhe inxhinierike nga planifikimi deri te monitorimi i ndërtimave në fushat e planifikimit urban, klinikat dhe spitalet, ndërtimet që lidhen me kishat, institucionet arsimore, industrinë dhe ndërtimet e biznesit, si dhe ndërtesa banimi të madhësive të ndryshme. Përveç kompetencave të tyre thelbësore të menaxhimit të kostos dhe kohës, kompania është e specializuar në zhvillimin dhe zbatimin e konstruksioneve të drurit. Helmut Hauser është qytetar tepër i angazhuar, duke shërbyer vullnetarisht si: anëtar i këshillit bashkiak të zonës, anëtar i këshillit të qarkut Calw, anëtar i Bordit Mbikëqyrës të Klinikverbund Südwest, anëtar i Bordit Këshillimor të "de'ignis-Fachklinik", anëtar i Bordit të shoqatës arkitektonike të Calw-Freudenstadt,

anëtar i DAW (Shoqëria Ekonomike gjermano-shqiptare) Berlin, dhe anëtar i këshillit të Fondacionit për Vlerat Thelbësore dhe Mirëkuptimin Ndërkombëtar në Berlin. Në vitin 1966, Helmut Hauser themeloi Black-Forest-Brass-Band tek e cila ai është akoma një trombonist aktiv. Pas udhëtimit të tij të parë në Shqipëri në 1992, ai pati takime të shumta me Nehemiah Gateway Albania në Shqipëri. Ndërsa vazhdoi të njihej me vendin dhe njerëzit e tij, brenda tij u rrit një dashuri dhe vlerësim për ta. Kontaktet vazhduan, ëndrrat u bënë realitet me kalimin e viteve pasi ata ishin në gjendje të ndërtojnë një larmi ndërtesash, siç janë shkollat, një universitet, një shtëpi për mysafirë, një kishë dhe një kompleks sportiv. Helmut Hauser është i martuar dhe ka një vajzë.

- Prof. Dr. Goran Rafajlovski - Profesor

Lindur në Shkup, Maqedoni. Goran Rafajlovski ka përfunduar studimet Bachelor i Shkencave në Inxhinieri Elektrike në Universitetin e Shkupit, duke vazhduar më tej me Master Shkencor në po këtë degë në Universitetin e Zagrebit në 1991. Ka përfunduar studimet e doktoraturës në Inxhinieri Elektrike në Universitetin e Shkupit në 1996. Është profesor në Departamentin e Inxhinierisë Elektrike në Universitetin e Shkupit dhe në Universitetin e SRH në Berlin. Z. Rafajlovski ka një karierë të pasur jo vetëm në fushën akademike dhe të energjistikës, por edhe në atë politike. Në periudhën 2001-2005, z. Rafajlovski ka qenë Ambasadori i Republikës së Maqedonisë në Gjermani. Ai ka qenë Këshilltar Hulumtues në Institutin e Themeluesve për Politikën Publike. Është anëtar i një sërë institucionesh dhe bordesh, nga ku mund të përmendim: anëtar në IEEE prej 25 vjetësh; anëtar I DAAD, Alumni VIP; 5 vjet Anëtar i Bordit Mbikëqyrës të ECM-së (Korporatës Elektrike të Maqedonisë); Anëtar i Komitetit të Enerjisë, Komisioni Evropian DG RTD Energy. Z. Rafajlovski është prej viti 2005 Kryetar i Bordit Menaxhues të Fondacionit Ndërkombëtar Boris Trajkovski. Në periudhën 2008-2011, ka punuar për RWE Innogy si Menaxher i Maqedonisë për Hidroenergjetikën dhe Aplikimet e reja për Evropën Juglindore dhe gjatë viteve 1998-2001, z. Rafajlovski ka qenë Administrator i ECM-së (Korporatës Elektrike të Maqedonisë). Z. Rafajlovski ka një gamë të gjërë publikimesh shkencore, nga ku numërohen më shumë se 80 botime dhe fjalime në revista dhe konferanca. Nga viti 2014 deri 2017 z. Rafajlovski ka qenë drejtuesi i Shkollës së Lartë Nehemiah Gateway.

- Arlinda Merdani -Projektet Ndërkombëtare dhe Burimet Njerëzore në NGS

Lindur në vitin 1982 në Elbasan. Arlinda Merdani ka përfunduar studimet në Degën Gjuhë Gjermane në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan, si dhe ka ndjekur disa semestra për këtë degë në Universitetin e Vjenës, Austri dhe Leipzig, Gjermani. Më tej, znj. Merdani ka vazhduar studimet master, me titullin Master i Studimeve Evropiane në Universitetin e Leipzig. Znj. Merdani ka kryer një praktikë në Bundestag-un gjerman, përvojë mjaft e vlefshme për të. Karriera e saj profesionale fillon në shtator 2005, ku znj. Merdani punon si përkthyes, dhe më vonë si Asistente e Menaxherit të Nehemiah Gateway në Shqipëri. Ajo kontribuoi në ngritjen e selisë së Nehemiah Gateway në Nuremberg në vitin 2010, duke fituar përvojë në ndërlidhjen e donatorëve, menaxhimin e zyrës, asistimin e takimeve të partnerëve dhe në menaxhimin e burimeve njerëzore. Znj. Merdani ka marrë pjesë në procedurat për hapjen e

Shkollës së Lartë Nehemiah Gateway dhe aktualisht është lektore në këtë shkollë për lëndën Metodat dhe Kërkimet Shkencore. Si Drejtuese e Operacioneve Globale për Nehemiah Gateway, znj. Merdani është përgjegjëse për zhvillimin dhe nxitjen e punës ndërkombëtare të Nehemiah Gateway si dhe për programin ndërkombëtar të bursave të Shkollës së Lartë Nehemiah Gateway. Nga tetori 2017- 2019 ajo gjithashtu ka marrë përgjegjësinë dhe si drejtore ekzekutive e Nehemiah Gateway gGmbH.

- Eliverta Götz - Kontroll dhe Raportim Financiar në NGS

Lindur në vitin 1983 në Pogradec, Shqipëri. Zj. Götz ka përfunduar studimet për ‘Gjuhë Shqipe’ në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan. Pas mësimdhënies në një shkollë publike, ajo u bashkua me stafin e shkollës Nehemia në Buçimas, Shqipëri dhe më vonë u bë pjesë e grupit të punës për të hapur Shkollën e Lartë Nehemiah Gateway. Njëkohësisht me punën e saj të mëvonshme si asistente e Drejtorit Menaxhues të Nehemiah Gateway, ajo përfundoi studimet për ‘Biznes dhe Ekonomi’ në Shkollën e Lartë Nehemiah Gateway duke vazhduar më pas me përfundimin e studimeve Master për ‘Sipërmarrje’ në Universitetin Ndërkombëtar SRH në Berlin. Aktualisht, puna e zj. Götz tek Nehemiah Gateway fokusohet në projektin e kontrollit dhe raportimit të financave në NGS.

- Kai Uellendahl - Këshillues Biznesi

Lindur në 1964 në Wuppertal. Në 1990, Kai Uellendahl u diplomua në Ekonomi nga Universiteti Ruhr në Bochum si dhe Universiteti Bergische në Wuppertal. Midis 1991 dhe 1999, ai punoi në departamente të ndryshme kontrolli për ndërmarrjen GRUNDIG. Pas kësaj, ai ishte i punësuar nga adidas-Solomon AG për nëntë vjet, duke shërbyer në pozicionet: e Kontrollit të Lartë (Evropë), CEO adidas Zvicër, si dhe CFO & COO për Solomon Central (Gjermani, Austri, Zvicër, Slloveni). Nga viti 2008 deri në vitin 2014, ai mbajti pozicionin e shefit të financave tek ROSEN Group. Pas pesë vjetësh si shef i financave të LUCERNE FESTIVAL, një nga promovuesit kryesorë në botë të koncerteve për muzikë klasike dhe bashkëkohore. Tani z.Uellendahl punon si një konsulent biznesi. Në 2002 ai ra në kontakt me Nehemiah Gateway Albania. Që atëherë ai ka mbështetur fondacionin me njoħuritë e tij profesionale dhe ka qenë kryetar i bordit mbikëqyrës nga 2009 deri në 2012. Kai Uellendahl është e martuar dhe ka tre fëmijë të rritur.

- Gerd Seitz

Gerd Seitz punon si avokat i pavarur dhe konsulent taksash në Mynih. Z. Seitz ka përfunduar provimet e para dhe të dyta shtetërore në drejtësi me fokus në ligjin e tregëtisë dhe taksave në Universitetet Mannheim dhe Tübingen (Gjermani), si edhe provimin për konsulent taksash. Ai ka një përvojë shumë-vjeçare profesionale, ndër të tjera edhe 20 vjet në firmën e tij ligjore me pesë bashkëpunëtorë në Mynih.

Nëpërmjet një mbështetësi dhe miku të rëndësishëm, ai lidhi kontakt me Nehemiah Gateway. Z. Seitz, si anëtar themelues i organizatës paraardhëse të Nehemiah Gateway Service, është përfshirë në mënyrë aktive në zhvillimin organizativ të NG Team që nga viti 2005.

IV.2.2. Organizimi i drejtimit

IV.2.2.1. Drejtori Ekzekutiv

Drejtori Ekzekutiv është organi më lartë ekzekutiv i Fondacionit Nehemiah Gateway Albainia. Aktualisht Drejtori Ekzekutiv është zonja Herolinda Shkullaku,

Znj. Shkullaku ka lindur në vitin 1976, në Pogradec. Pas përfundimit të studimeve për gjuhë angleze në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës, znj. Shkullaku punoi për tre vjet si mësuese e gjuhës angleze dhe asaj gjermane në një nga shkollat e mesme të bashkisë Pogradec dhe më pas në Shkollën Nehemia. Prej vitit 2002, bashkëpunimi me Nehemiah Gateway u thellua më tej kur Znj. Shkullaku mori përsipër disa funksione si Asistente e Kryetarit të Bordit Ekzekutiv dhe më pas Asistente e Kryetarit të Bordit Mbikëqyrës për një periudhë 6 vjeçare. Njëkohësisht, ajo fitoi përvojë si Drejtuese e Projektit të Gjuhëve të Huaja dhe Forumit Profesional në këtë organizatë.

Në vitin 2009, znj. Shkullaku u emërua Drejtuese e Qendrës Kombëtare të Nehemiah Gateway Albania, duke koordinuar punën për 9 qendrat lokale në gjithë Shqipërinë si dhe shërbimet qendrore të Burimeve Njerëzore. Gjatë kësaj periudhe, ajo përfundoi me sukses studimet e dyta në Degën Biznes dhe Ekonomi pranë Shkollës së Lartë Nehemiah Gateway. Në janar 2013, znj. Shkullaku u emërua Drejtori Ekzekutiv e Nehemiah Gateway Albania.

Të Nehemiah Gateway Albania, ajo shikon një mundësi për t'i shërbyer vendit të saj, duke ofruar modele dhe duke ndihmuar e fuqizuar njerëzit në nevojë dhe sidomos të rinxitë që në mënyrë të qëndrueshme të ndërtojnë jetët e tyre me dinjitet dhe pavarësi. Znj. Shkullaku është e martuar dhe ka një djalë.

IV.2.2.2. Vendimmarja dhe raportimi

Fondacioni Nehemiah Gateway Albania drejtohet nga Drejtori Ekzekutiv dhe dy Zëvendës Drejtorë.

Kampusi në Buçimas, ku edhe ndodhet selia janë edhe zyrat qendrore të Fondacionit.

Po ashtu çdo degë/ qendër lokale ka drejtuesin e vet. Çdo degë/qendër lokale ka progame të cilat drejtohen nga drejtues Didaktikë apo Teknikë sipas licensave përkatëse.

Për të lehësuar punën e drejtuesve të degëve/ qendrave lokale, janë ngritur qendra kompetence qendrore në Financë, Çështje Ligjore, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, IT, PR e Media, si dhe Menaxhim Infrastruktura e Projekteve Mbështetëse. Këto qendra drejtohen nga specialistë dhe mbështesin punën e drejtuesve të degëve/qendrave lokale. Shkolla e Lartë Nehemiah Gateway drejtohet nga Senati Akademik, Rektori, Bordi Administrativ dhe Administratori sipas Ligjit për Arsimin e Lartë.

Ekzekutivi raporton, ndjek udhëzimet dhe zbaton vendimet e Bordit Mbikëqyrës.

Të gjitha hapat që duhen ndjekur përmarrjen e vendimeve janë të përcaktuar në manual përkomunikimin e brendshëm dhe informacionin e shkruar. Të gjithë bashkëpuntorët bazuar në pozicionin që kanë janë të informuar se çfarë hapash duhet të ndjekin përmarrjen apo aprovimin e buxhetit, projekteve, dokumentave, etj. Përveç manualit dhe procedurave të shkruara bashkëpuntorët janë pjesë e takimeve dhe trajnimeve të vazhdueshme në lidhje me politikat e vendimmarres dhe procedurave të reja që duhen ndjekur.

V. Planet për të ardhmen

Fondacioni Nehemiah Gateway Albania do të vazhdojë punën në katër shtyllat strategjike përmbrëtore qëllimet dhe misionin e vet. Pavarsisht vështirësive me situatën e krijuar nga COVID-19, Fondacioni do të sigurojë vijimësi në të gjitha aktivitetet që kryen. Fondacioni do të vazhdojë të menaxhojë me kujdes të gjitha të ardhurat dhe të jetë transparent me të gjithë donatorët nëpërmjet komunikimit të hapur dhe të vazhdueshëm. Do të respektojë dhe ndjekë rregullat dhe standarde kontabilitetit përmbrëtore pasur një pasqyrim sa më transparent dhe të plotë të gjithave veprimeve ekonomike.


Hartuar



Elona Blacéri

Drejtuese e Financës

Miratuar



Herolinda Shkullaku

NEHEMIAH GATEWAY
ALBANIA

Drejtore Ekzekutive

Fondacion
Rr. Nehemia - 7304 Buçimas